



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE**

ORGANIZON

Në bashkëpunim me

DEPARTAMENTIN E GJUHËS ANGLEZE

dhe

**UNIVERSITETIN IONIAN, GREQI
FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTIN E GJUHËVE TË HUAJA, PËRKTHIMIT DHE
INTERPRETIMIT**

FTESË PËR PJESËMARRJE

NË

KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE,

ME TEMË:

**«PËRKTHIMI DHE KOMUNIKIMI,
SFIDAT DHE PËRPARËSITË NË RRAFSHIN
NDËRKOMBËTAR»**

28 PRILL 2023, FGJH

SALLA "EUROPA", ora 09:00



Të dashur kolegë,

Ftojme të gjithë studiuesit, pedagogët, doktorantët, studentët pasuniversitarë dhe profesionistët e fushës të marrin pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë bosht **«PËRKTHIMI DHE KOMUNIKIMI, SFIDAT DHE PËRPARËSITË NË RRAFSHIN | NDËRKOMBËTAR»**, që do të organizohet më 28 prill, 2023.

Komunikimi dhe Përkthimi janë aftësi të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Është përkthimi ai që bën të mundur komunikimin ndërkulturor, ndërkombëtar dhe ndërgjuhësor. Për më tepër, nevoja për përkthim shpesh pason nevojën për të komunikuar. Duke pasur parasysh gamën e aftësive të gjuhëve të huaja dhe amtare të disponueshme në mbarë globin, komunikimi në çdo gjuhë mund të paraqesë një sfidë, dhe pikërisht këtu hyn nevoja për përkthim.

Optika e konferencës sonë do të fokusohet në aspekte shkencore-kërkimore të fushës së përkthimit dhe komunikimit; ajo do të bazohet mbi hulumtime, këndvështrime, të cilat japin lëndë të mjaftueshme për analiza e përgjithësime për studiuesit dhe do të fokusohet kryesisht, në këto nëntema:

Nëntemat e konferencës:

Kultura dhe Gjuha

- *Komunikimi ndërkulturor*
- *Alfabetizimi kulturor*
- *Letërsia dhe mësimi i gjuhës*
- *Peizazhe gjuhësore*
- *Gjuha përballë ndryshimeve shoqërore dhe kulturore*
- *Gjuhësia kompjuterike*

Përkthimi

- *Përkthimi, kultura dhe ideologjia në kohë*
- *Përkthimi i referencave kulturore*
- *Përkthimi i njësive frazeologjike*



- *Frazeologjia dhe fjalorët elektronikë*
- *Përkthimi audiovizual*
- *Përkthimi kulturor dhe ndërnjetësinë*
- *Mësimdhënia, përvetësimi i kompetencës kulturore në Studime Përkthimore*
- *Teknologjitë e reja të përkthimit*
- *Interpretimi dhe përkthimi.*

Konferenca do të mbahet në Tiranë më 28 prill 2023 dhe punimet/abstraktet do të publikohen në Tiranë, Shqipëri. Gjuhët referuese do të jenë shqip, greqisht dhe anglisht.

Veprimtaria shkencore organizohet nga Departamenti i Gjuhës Greke, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës (Shqipëri) në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhëve të Huaja, Përkthimit dhe Interpretimit, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Ionian, Korfuz (Greqi).

DATA DHE AFATE TE RËNDËSISHME

Dorëzimi i abstrakteve:	1 -15 prill 2023
Zhvillimi i Konferencës:	28 prill 2023
Dorëzimi i punimeve të plota për publikim:	11 qershor 2023

Të dhëna për dërgimin e abstrakteve:

- *Abstraktet e punimeve duhet të dërgohen në adresën: departamenti.greqisht@unitir.edu.al në shqip dhe anglisht.*
- *Abstrakti duhet të jetë në formatin "Word", me jo më shumë se 250 fjalë.*
- *Për pranimin e abstraktit do të njoftoheni më 17 prill 2023.*

Abstrakti duhet të përfshijë:

- *Titullin e kumtesës (të theksuar, të qendëruar, me shkrim "TimesNew Roman", madhësia 14);*
- *Emrin e autorit (titullin e tij shkencor, institucionin ku është i punësuar, adresa e "e-mail"-it, madhësia 11);*



- *Tekstin (shkrimi i përdorur: "TimesNew Roman", madhësia 12, "margjina" normale, hapësira "single"*
- *Fjalët kyçe (maksimalisht 5, madhësia 11, me shkrim të pjerrët).*

Për më shumë informacion ju lutemi kontaktoni në e-mailin

departamenti.greqisht@unitir.edu.al

Koordinatorë e konferencës:

Prof.Asoc.Dr. Sofia Delijorgji

Bordi shkencor:

Prof.Dr. Esmeralda Kromidha

Prof.Dr. Georgios Kentrotis

Prof.Dr. Viktor Ristani

Prof.Asoc.Dr. Sofia Delijorgji

Prof.Asoc.Dr. Ioannis Karra s

Prof.Dr. Sotiris Livas

Prof. Asoc.Dr. Lito Alexaki

Prof.Dr. Saverina Pasho

Prof. Asoc.Dr. Adriatik Derjaj

Prof. Asoc. Dr. Mirela Papa

Prof.Dr. Marsela Lika

Dr. Rudina Xhillari

Bordi organizativ:

Dr. Isida Metaj

Dr. Edlira Jorgaqi

Prof.Asoc.Dr. Iris Klosi

Dr. Eneida Mataj

Dr. Elvis Bramo